



# FAZA E RE E DIALOGUT KOSOVË-SERBI



**KËNDVËSHTRIMI  
I QYTETARËVE**



DEMOKRATIZIMI  
DHE PRAKTIKAT  
PARLAMENTARE







# FAZA E RE E DIALOGUT KOSOVË-SERBI



**KËNDVËSHTRIMI  
I QYTETARËVE**



COPYRIGHT © 2017. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,  
10 000, Prishtinë, Kosovë.  
Tel.: +381 (0)38 248 038  
E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)  
Ueb: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Vërejtje: Ky raport është rezultat i një hulumtimi që është realizuar në kuadër të projektit "Forcimi i mbikëqyrjes parlamentare të ekzekutivit dhe rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në dialogun Kosovë-Serbi", i financuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës, dhe në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet që reflekton qëndrimet e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës.



# PËRMBAJTJA

06 HYRJE

07 METODOLOGJIA

08 PYETJET E SONDAZHIT

10 **1** Çfarë roli prisni të ketë Presidenti Thaçi në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi?

12 **2** Çfarë roli prisni të ketë (në të ardhmen) Kuvendi i Kosovës në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi?

14 **3** A mendoni se BE duhet të bëhet garantuese e marrëveshjeve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke vendosur sanksione për palët që nuk i zbatojnë marrëveshjet e arritura?

16 **4** Çfarë do të thotë për ju normalizim i marrëdhënieve Kosovë-Serbi?

18 PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME



# HYRJE

Hulumtimi i opinionit publik “Faza e re e dialogut Kosovë-Serbi: këndvështrimi i qytetarëve” është i katërti që KDI organizon për të nxjerrë në pah opinionin e qytetarëve rreth procesit të dialogut dhe rezultateve të dala prej tij.

Që nga janari 2017, Presidenti i Republikës së Kosovës z. Hashim Thaçi ka udhëhequr bisedimet në mes Kosovës dhe Serbisë të ndërmjetësuar nga BE. Incidentet e njëpasnjëshme si ai me ndërtime të murit në pjesën veriore të Mitrovicës dhe trenin të nisur nga Serbia për në Kosovë me ikonografi fetare prodhuan situatë të tensionuar në mes shteteve. Të gjitha këto rrjedha si dhe ngecjet në zbatimin e marrëveshjeve bënë që, Brukseli të veprojë më proaktivisht duke ftuar palët për të vazhduar dialogun.

Palët deklaruan gatishmëri të tyre për vazhdimin e këtij procesi për të hapur edhe fazën përmbyllëse të këtij procesi, në fund të së cilës BE deklaroi se pritet që palët të nënshkruajnë një marrëveshjeve ligjrisht të obligueshme.

Në një tryezë të organizuar nga KDI<sup>1</sup> në muajin shtator (2017), Presidenti Thaçi ka diskutuar me shoqërinë civile dhe mediat rreth idesë së një ekipi uniteti për të garantuar gjithpërfshirje në dialog. Ai poashtu përmendi idenë e një referendumi për marrëveshjen përfundimtare me shtetin serb. Iniciativa e Presidentit Thaçi për ekip uniteti u prit me reagime të ndryshme, të pritura për publikun. Një pjesë e shoqërisë civile dhe partive politike e kanë vlerësuar si iniciativë të qëlluar ndërsa pjesë tjetër kanë shprehur skepticizmin dhe hezitimin e tyre për t’u bërë pjesë e këtij ekipi.

Përmbajtja e ekipit negociues të dialogut, roli i Qeverisë, Kuvendit dhe opozitës, i shoqërisë civile e medias, temat e diskutimit dhe epilogu i procesit të dialogut, roli i BE-së dhe SHBA-ve janë ende çështje në diskutim e sipër në skenën politike të Kosovës.

Është evidente që kritika më e madhe e këtij procesi ka qenë mungesa e transparencës, e debatit të gjerë politik dhe publik. KDI në vazhdimësi ka proklamuar për një proces dialogues gjithpërfshirës, duke kërkuar që institucionet, partitë politike dhe qytetarët bashkërisht të japin kontribut në këtë proces dhe mbi të gjitha të garantojnë transparencë dhe llogaridhënie.

Në fokus të këtij sondazhi është pikërisht faza e re dhe përmbyllëse e dialogut Kosovë-Serbi, përkatësisht ndikimi i rolit të Presidentit të Kosovës në dialogun Kosovë-Serbi, rolin që Kuvendi duhet ta ketë dhe pozicionin të cilin BE duhet ta mbaj për të garantuar zbatimin e marrëveshjeve të arritura. Mbi të gjitha, fokus të veçantë në këtë sondazh është edhe nocioni i normalizimit të marrëdhënieve në mes dy vendeve, interpretimi i të cilët ketë herë shpërfaqet nga këndvështrimi i qytetarëve.

Në këtë sondazh vihet re skepticismi i qytetarëve rreth rezultateve që ndryshimi i formatit të dialogut do të sjell në rritjen e transparencës dhe gjithpërfshirjes, kërkesa për një rol të shtuar dhe më të fuqishëm të Kuvendit të Kosovës në këtë proces, rreth ndryshimit të rolit të BE-së dhe mbi të gjitha si e vlerësojnë qytetarët normalizimin e marrëdhënieve në mes dy vendeve.

Këto sondazhe organizohen në kuadër të misionit të KDI-së për të promovuar transparencën, llogaridhënien dhe demokracinë e përgjegjshme. Ky projekt është i financuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës për forcimin e mbikëqyrjes parlamentare të ekzekutivit dhe rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në dialogun Kosovë-Serbi.

<sup>1</sup> Për më shumë shih në <http://votaim.org/Public/DialogActivity/Detail/130>






## 2. METODOLOGJIA



Sondazhi është zhvilluar në nivel vendi duke përdorur metodën sistematike të rastësisë, me mostër prej 1065 të anketuarëve e dizajnuar për sigurimin e mostrës përfaqësuese, e shtresuar sipas

etniciteteve: shqiptar, serb dhe minoritete jo-serbe, shtrirja sipas vendbanimeve (ubane/rurale). Sondazhi është realizuar në periudhën kohore Shtator 2017. Margjina e gabimit është rreth  $\pm 3\%$ .




Në këtë sondazh vihet re skeptizicmi i qytetarëve rreth rezultateve që ndryshimi i formatit të dialogut do të sjell në rritjen e transparencës dhe gjithpërfshirjes, kërkesa për një rol të shtuar dhe më të fuqishëm të Kuvendit të Kosovës në këtë proces, rreth ndryshimit të rolit të BE-së dhe mbi të gjitha si e vlerësojnë qytetarët normalizimin e marrëdhënieve në mes dy vendeve.









# **PYETJET E SONDAZHIT**



# Çfarë roli prisni të ketë Presidenti Thaçi në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi?

Q

Që nga fillimi e deri më tani, dialogu Kosovë-Serbi ka kaluar në tri faza të ndryshme. Faza e parë e dialogut filloi si dialog teknik, ku ekipet negociuese përbëheshin nga të emëruar të posaçëm të të dy Qeverive. Më vonë, filloi një fazë e re e tij e dialogut politik ku negociimi në Bruksel u udhëhoq nga Kryeministrat e të dyja vendeve. Tani kur pritet të filloj faza e tretë dhe përmbyllëse e dialogut, lidërshipi dhe udhëheqja e këtij procesi pritet të bëhet nga Presidentet e të dy shteteve.

## **Por, çfarë presin qytetarët e vendit nga Presidenti Thaçi në këtë fazë të re të dialogut?**

Nga hulumtimi i kryer në terren nga KDI, janë 33% e të anketuarëve të cilët vlerësojnë se dialogu do të vazhdoj të mbetet i njëjtë, kundrejt 27% e tyre që kanë deklaruar se Presidenti Thaçi nuk do të përmirësoj nivelin e bisedimeve me Serbinë e as nuk do të arrijë të garantoj transparencë

dhe gjithpërfshirje. Pra, shumica e qytetarëve përkatësisht 60% e tyre vlerësojnë se përfshirja e Presidentit Thaçi nuk do të përmirësojë nivelin e bisedimeve në dialog duke garantuar gjithpërfshirje dhe transparencë dhe dialogu do të vazhdoj të jetë i njëjtë.

Vetëm 31% e të anketuarve kanë vlerësuar se Presidentit Thaçi do të ketë rol pozitiv në dialogun Kosovë-Serbi duke përmirësuar nivelin e bisedimeve në dialog duke garantuar gjithpërfshirje dhe transparencë. Ndërsa vetëm 9% e qytetarëve të anketuar nuk e dinë se çfarë impakti do të ketë përfshirja direkte e Presidentit Thaçi në dialogun Kosovë-Serbi.



# 33%

Dialogu do të vazhdojë të jetë i njëjtë

K - SHQIPTAR  = ● 33%

K - SERB  = ● 27%

K - TË TJERË  = ● 29%

# 31%

Do ta përmirësojë nivelin e bisedimeve në dialog duke garantuar gjithëpërfshirje dhe transparencë

K - SHQIPTAR  = ● 32%

K - SERB  = ● 11%

K - TË TJERË  = ● 25%

# 27%

Nuk do të përmirësoj nivelin e bisedimeve në dialog, dhe nuk do të garantoj gjithëpërfshirje dhe transparencë

K - SHQIPTAR  = ● 28%

K - SERB  = ● 13%

K - TË TJERË  = ● 28%

# 9%

Nuk e di

K - SHQIPTAR  = ● 7%

K - SERB  = ● 49%

K - TË TJERË  = ● 19%

### Qëndrimi i qytetarëve rreth rolit të Presidentit Thaçi në dialogun Kosovë-Serbi sipas përkatësive etnike

Sa i përket qëndrimit të qytetarëve sipas përkatësisë etnike, janë 33.5% e të anketuarve nga komuniteti shqiptar vlerësojnë se përfshirja e Presidentit Thaçi nuk do të ketë ndikim pozitiv e as negativ në procesin e dialogut. Ndërsa 27.5% kanë deklaruar se Presidenti Thaçi nuk do të arrij të përmirësoj nivelin e bisedimeve dhe nuk do të garantoj gjithëpërfshirje dhe transparencë. Pra, shumica e të anketuarve nga komuniteti shqiptar përkatësisht 65% e tyre vlerësojnë se përfshirja e Presidentit Thaçi në procesin e dialogut Kosovë-Serbi nuk do të ketë ndikim apo të sjell ndryshime pozitive.

Ndërkohë, 32% e të anketuarve nga komuniteti shqiptar vlerësojnë se Presidenti Thaçi do të përmirësoj nivelin e bisedimeve me Serbinë duke garantuar gjithëpërfshirje dhe transparencë.

Sa i përket qëndrimit të qytetarëve të komunitetit serb, pothuajse gjysma e të anketuarve përkatësisht 48.7% nuk kanë opinion nëse Presidenti Thaçi do të sjellë impakt pozitiv apo negativ në proces. Ndërsa 27.3% e të anketuarve nga komuniteti serb kanë deklaruar se dialogu do të mbetet i njëjtë, 10.7% janë deklaruar se dialogu do të përmirësohet kurse 13.3% thanë se dialogu do të vazhdoj të jetë i njëjtë edhe më përfshirjen e Presidentit Thaçi.

Edhe komunitetet tjera joshumicë janë deklaruar pothuajse njëjtë sikurse të anketuarit nga komuniteti shqiptar. Shumica e tyre përkatësisht 53% kanë vlerësuar se përfshirja e Presidentit Thaçi nuk do të ketë ndikim në dialog dhe as në përmirësimin e nivelit të bisedimeve apo transparencës dhe gjithëpërfshirjes. Ndërsa 24.7% e tyre vlerësojnë se Presidenti Thaçi do të përmirësoj nivelin e bisedimeve me Serbinë duke garantuar gjithëpërfshirje dhe transparencë.

# 2

## Çfarë roli prisni të ketë (në të ardhmen) Kuvendi i Kosovës në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi?

**K**uvendi i Republikës së Kosovës, si institucioni i vetëm i cili përfaqëson direkt qytetarët e vendit dhe njëkohësisht ushtron kompetenca mbikëqyrëse ndaj Qeverisë, me anë të Rezolutave të miratuara i ka dhënë të drejtën ekipit negociues të dialogoj në Bruksel me Serbinë duke e obliguar të zhvilloj raportime të rregullta në Kuvend dhe Komisione Parlamentare.

Pavarësisht përpjekjeve të deputetëve dhe komisioneve të caktuara parlamentare gjatë legjislaturës së kaluar për të rritur llogaridhënien dhe transparencën nga ana e Qeverisë për procesin e dialogut Kosovë-Serbi, ky institucion ka qenë i anashkaluar, i papërfshirë dhe jo i informuar sa duhet për marrëveshjet e arritura dhe në përgjithësi për tërë procesin. Ndërsa roli i këtij institucioni në të ardhmen e këtij procesi mbetet ende për tu përcaktuar.

KDI ka pyetur qytetarët se çfarë roli presin ata nga të zgjedhurit e tyre në fazën e re të dialogut.

Pothuajse gjysma e qytetarëve të anketuar përkatësisht 47.7% e tyre kanë deklaruar se Kuvendi duhet të kërkoj raportim të rregullt dhe transparencë nga Ekipi Negociator, Presidenti dhe Qeveria, para dhe pas çdo raundi të bisedimeve në Bruksel. Janë 33.4% e qytetarëve të cilët kanë konsideruar se Kuvendi duhet të luaj rol të njëjtë si deri tani dhe të kërkoj kohë pas kohe raportim nga Ekipi Negociator, kurse 7.8% e qytetarëve janë deklaruar se Kuvendi nuk duhet të përfshihet fare në çështjet e dialogut. 11% e të anketuarve nuk kanë pasur përgjigje se çfarë duhet të jetë roli i Kuvendit në këtë proces.

48%

Të kërkoj raportim të rregullt dhe transparencë nga Ekipi Negociator (Presidenti dhe Qeveria) para dhe pas çdo roundi të dialogut

K - SHQIPTAR = 49%

K - SERB = 6%

K - TË TJERË = 38%

33%

Të luaj rol të njëjtë si deri tani, duke ftuar Ekipin Negociator kohë pas kohe për të raportuar mbi marrëveshjet dhe mbarëvajtjen e dialogut

K - SHQIPTAR = 34%

K - SERB = 7%

K - TË TJERË = 29%

11%

Nuk e di

K - SHQIPTAR = 9%

K - SERB = 67%

K - TË TJERË = 20%

8%

Të mos përfshihet në çështjen e dialogut

K - SHQIPTAR = 7%

K - SERB = 20%

K - TË TJERË = 13%

### Qëndrimi i qytetarëve rreth rolit të Kuvendit në dialogun Kosovë-Serbi në baza etnike

Sa i përket qëndrimit të qytetarëve sipas përkatësisë etnike rreth rolit të Kuvendit në fazën e re të dialogut, shumica e të anketuarve të komunitetit shqiptar përkatësisht 49.4% e tyre dhe e komuniteteve tjera joshumicë përkatësisht 38.1% e tyre kanë kërkuar rol më të madh nga Kuvendi, duke kërkuar më shumë transparencë dhe llogaridhënie nga Ekipi Negociator që të ftohet çdoherë para dhe pas secilit raund të bisedimeve me Serbinë. Vetëm 6% e qytetarëve të anketuar nga komuniteti serb kanë kërkuar rol më të madh nga Kuvendi.

Konsistencë në punën e Kuvendit dhe thirrje në raportim kohë pas kohe të Ekipit Negociator kanë kërkuar 34.4% e të anketuarve nga komuniteti shqiptar, 6.7% nga komuniteti serb dhe 28.9% e komuniteteve tjera joshumicë. Ndërsa,

sa i përket idesë së mospërfshirjes së Kuvendit në çështje të dialogut, me këtë janë pajtuar vetëm 7.2% e të anketuarve nga komuniteti shqiptar, 20% nga komuniteti serb dhe 13.4% nga komunitetet tjera joshumicë.

Vlenë të përmendet se se 67.3% e të anketuarve nga komuniteti serb kanë deklaruar se nuk kanë përgjigje kur janë pyetur se çfarë roli duhet të ketë Kuvendi, karshi 9% të të anketuarve shqiptarë dhe 13% të anketuarve serb.

Ajo çfarë mund të konkludohet mbi këto të dhëna është që qytetarët janë në konfuzion rreth rolit të Kuvendit në dialog. Kjo mund të jetë për shkak të jotransparencës së deritanishme dhe të ambiguiteteve në interpretimin e marrëveshjeve në Beograd dhe Prishtinë.



# 3

## A mendoni se BE duhet të bëhet garantuese e marrëveshjeve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke vendosur sanksione për palët që nuk i zbatojnë marrëveshjet e arritura?

**N** Nga fillimi i dialogut mes Kosovës dhe Serbisë më 2011 deri më tani, janë arritur gjithësej 23 marrëveshje, shumica prej tyre me shumë marrëveshje të tjera specifike me anë të së cilave synohej rregullimi i detajuar i çështjeve për të cilat diskutohet në Bruksel. Një numër shumë i vogël i marrëveshjeve ka gjetur zbatim ndërsa ka vazhduar procesi i rinegociimit të tyre dhe i përcaktimit të afateve kohore të reja për zbatim, të cilat sërish nuk janë respektuar. Kosova shpesh herë në raportimet zyrtare të dorëzuara në BE ka fajësuar Serbinë për moszbatim të marrëveshjeve dhe mosrespektim të ujdive.

Duke konsideruar se procesi i dialogut Kosovë-Serbi është i lehtësuar nga BE dhe se ky proces është i lidhur me rrugëtimin e të dy vendeve drejtë BE-së, konsiderohet si tejet e nevojshme krijimi i mekanizmave zbatues dhe garanca nga ana e BE-së për zbatimin e marrëveshjeve, duke përdorur mekanizmat që ka në

dispozicion për të kushtëzuar të dy palëve për të zbatuar marrëveshjet.

Pikërisht këtë pyetje, KDI iu ka parashtruar edhe qytetarëve të vendit, për të konstatuar se cili është qëndrimi i tyre rreth mundësisë që BE-ja të shërbej si garantues i zbatimit të marrëveshjeve.

Shumica dërmuese e të anketuarve përkatësisht 75.5% e tyre vlerësojnë se BE duhet të shërbej si garantues i zbatimit të marrëveshjeve mes Kosovës dhe Serbisë duke vendosur sanksione për palët që nuk i zbatojnë marrëveshjet e Brukselit.

Ndërsa vetëm 9.3% e qytetarëve vlerësojnë se BE nuk duhet ta luaj këtë rol. Ndërkaq 15.2% e të anketuarve nuk kishin përgjigje nëse BE duhet të bëhet garantuese e marrëveshjeve mes Kosovës dhe Serbisë apo jo.



76% PO

K - SHQIPTAR 78%

K - SERB 13%

K - TË TJERË 65%

9% JO

K - SHQIPTAR 8%

K - SERB 31%

K - TË TJERË 13%

15% NUK E DI

K - SHQIPTAR 14%

K - SERB 57%

K - TË TJERË 22%

#### **Qëndrimi i qytetarëve rreth rolit të BE-së në dialogun Kosovë-Serbi sipas ndarjes etnike**

Sa i përket qëndrimit të qytetarëve rreth rolit të BE-së në dialogun Kosovë-Serbi sipas ndarjes etnike, shumica e të anketuarve nga komuniteti shqiptar përkatësisht 77.9% dhe atyre nga komunitetet tjera joshumicë përkatësisht 64.9% pajtohen se BE duhet të bëhet garantuese e zbatimit të marrëveshjeve dhe të sanksionoj palët në rast të mos-zbatimit të tyre, kundrejt vetëm 12.7% të respondentëve serb të cilët kanë përkrahur një ide të tillë.

Respondentët nga komuniteti serb përkatësisht 30.7% nuk pajtohen me idenë që BE të jetë garantuese e marrëveshjeve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë apo të vendos sanksione për palët që nuk i zbatojnë ujditë. Mospajtim rreth kësaj ideje kanë shfaqur edhe 8.4% të respondentëve të komunitetit shqiptarë dhe 13.4% të komuniteteve tjera joshumicë.

Ndërsa në masë të madhe respondentët nga komuniteti serb përkatësisht 56.7% janë të pavendosur rreth rolit që BE duhet të luaj në kuadër të këtij procesi, kundrejt 13.7% të respondentëve shqiptarë dhe 21.6% të respondentëve nga komunitetet tjera joshumicë.



# 4

## Çfarë do të thotë për ju normalizim i marrëdhënieve Kosovë-Serbi?

**N**jë nga çështjet kryesore që ndërlidhet me procesin e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë është vetë epilogu i këtij dialogu. Përderisa dialogu ka hyrë në fazën e tretë dhe të fundit të tij, qytetarët e Republikës së Kosovës vazhdojnë të dëgjojnë qëndrime të ndryshme nga lidhshipi i të dy palëve lidhur me epilogun e këtij procesi.

Shpeshherë është përmendur se në fund të procesit të dy shtetet do të nënshkruajnë një marrëveshje ligjore të obligueshme që do të bëjë të mundur “normalizimin e marrëdhënieve” në mes dy shteteve. Mirëpo, përkundër përdorimit të shpesh të këtij termi, nuk ka një qëndrim të vetëm zyrtar se çfarë nënkuptohet me normalizim marrëdhëniesh, se çfarë në të vërtetë nënkupton ky nocion. Opsionet e diskutuara të ndërlidhura me normalizimin e marrëdhënieve janë të ndryshme si njohja reciproke, kërkim falja, heqja e Kosovës nga kushtetuta e Serbisë, reparacionet, mos-pengimi i shteteve në rrugën e tyre drejt integriteteve euroatlantike.

### Por, çka nënkupton normalizimi i marrëdhënieve Kosovë – Serbi për qytetarët e Kosovës?<sup>1</sup>

Janë 71% e të anketuarve të sondazhit të cilët vlerësojnë se elementare për normalizimin e marrëdhënieve në mes Kosovës dhe Serbisë është kërkim falja nga ana e Serbisë për krimet e kryera në Kosovë.

Ndërsa 57% e të anketuarve e kanë përmendur gjithashtu se normalizimi arrihet me njohjen reciproke, 45% e tyre heqjen e Kosovës nga Kushtetuta e Serbisë, si dhe 37% e të anketuarëve kanë vlerësuar se normalizimin nënkupton mos-bllokimi i palëve në rrugën drejt integriteteve evropiane dhe anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare, pa pasur nevojë të njohin njëra-tjetrën.

<sup>1</sup> Kjo pyetje është me përgjigje të shumëfishtë





# 71%

Kërkim falje për krimet e luftës nga ana e Serbisë

K - SHQIPTAR = 73%

K - SERB = 7%

K - TË TJERË = 68%

# 57%

Njohje reciproke

K - SHQIPTAR = 59%

K - SERB = 2%

K - TË TJERË = 41%

# 45%

Heqja e Kosovës nga Kushtetuta e Serbisë

K - SHQIPTAR = 46%

K - SERB = 18%

K - TË TJERË = 31%

# 37%

Të dyja palët, pa pasur nevojë të njohin njëra-tjetrën, të vazhdojnë rrugën evropiane të anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare, pa bllokuar njëra-tjetrën

K - SHQIPTAR = 36%

K - SERB = 60%

K - TË TJERË = 40%

# 0%

 Tjetër

K - SHQIPTAR = 0%

K - SERB = 11%

K - TË TJERË = 0%

# 0%

 Nuk e di

K - SHQIPTAR = 0%

K - SERB = 14%

K - TË TJERË = 0%

## **Çka nënkupton normalizimi i marrëdhënieve Kosovë – Serbi për qytetarët e Kosovës sipas ndarjes etnike**

Për respondentët e komunitetit shqiptarë, përkatësisht për 73% të tyre normalizim i marrëdhënieve fillimisht nënkupton kërkim-falja nga ana e Serbisë për krimet e luftës, njohja reciproke është përmendur gjithashtu nga 59% e respondentëve. Ndërsa heqja e Kosovës nga Kushtetuta e Serbisë e kanë përmendur edhe 46% e respondentëve nga komuniteti shqiptar dhe 36.4% e tyre kanë përmendur edhe mos-bllokimin reciprok i të dyja shteteve në rrugëtimin e tyre drejt BE-së dhe anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare pa pasur nevojë të njohin njëra-tjetrën, si normalizim marrëdhëniesh. Respondentët nga komuniteti serb kanë një këndvështrim tjetër sa i përket çështjes së normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. Sipas respondentëve të komunitetit serb, normalizimi i marrëdhënieve në mes vendeve fillimisht nënkupton për 60% të tyre mos-bllokim të njëra-tjetrës

në rrugën drejt integritimit evropian dhe anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare, pa pasur nevojë që shtetet të njohin njëra-tjetrën. Janë 18% e respondentëve të komuniteti serb që e kanë përmendur edhe heqjen e Kosovës nga Kushtetuta serbe si normalizim marrëdhëniesh. Ndërsa, vetëm 6.7% e respondentëve nga komuniteti serb e kanë përmendur kërkim-faljen për krime të luftës si dhe vetëm 2% e qytetarëve nga komuniteti serb kanë vlerësuar se njohja reciproke nënkupton normalizim marrëdhëniesh.

Kurse, sa u përket respondentëve nga komunitetet tjera joshumicë, shumica e tyre me normalizim marrëdhëniesh nënkuptojnë kërkim-faljen nga ana e Serbisë për krimet e luftës (68%), ndjekur nga njohja reciproke mes dy shteteve (41%), mos-bllokimi i njëra-tjetrës në rrugën drejt BE-së dhe anëtarësimin në organizata ndërkombëtare pa pasur nevojë të njohin njëra-tjetrën (40%) dhe e fundit largimi i Republikës së Kosovës nga Kushtetuta e Serbisë (31%).



# PËRFUNDIM

Në sondazhin e katërt për matjen e opinionit publik rreth dialogut Kosovë- Serbi, KDI ka adresuar çështje që ndërlidhem me të ardhmen e këtij procesi. Më specifikisht, KDI ka synuar të shpërfaqë pritshmëritë e qytetarëve për rolin dhe ndikimin e Presidentit të Kosovës në dialogun Kosovë-Serbi, në rolin që Kuvendi duhet ta luaj në këtë proces si dhe rolin e BE-së për të garantuar zbatimin e marrëveshjeve. Gjithashtu KDI ka pyetur qytetarët se çfarë nënkupton për ta normalizimin i marrëdhënieve në mes dy vendeve.

## Të gjeturat e sondazhit nxjerrin në pah se:

### **01** Shqiptarët dhe serbët e kuptojnë drastikisht ndryshe normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi.

Rreth 71% e qytetarëve vlerësojnë se element kryesor për normalizim i marrëdhënieve në mes Kosovës dhe Serbisë është kërkim falja për krimet e luftës nga ana e Serbisë. Rreth 60% e qytetarëve të komunitetit serb në Kosovë e interpretojnë normalizimin si mos pengim të njëra-tjetrës palë në rrugëtimin evropian apo anëtarësimin në organizata ndërkombëtare, pa pasur nevojë që shtetet të njohin njëra-tjetrën. Ndërsa të anketuarit nga komuniteti shqiptar (73%) dhe komunitetet e tjera (68%) elementare për normalizim marrëdhënies vlerësojnë se është kërkim falja nga ana e Serbisë për krimet e luftës në Kosovë.

### **02** Nuk pritet ndryshim i madh i dialogut me përfshirjen e Presidentit Thaçi

Janë 33% e të anketuarëve të cilët vlerësojnë se dialogu do të vazhdojë të mbetet i njëjtë, dhe 27% e tyre që kanë deklaruar se Presidenti Thaçi nuk do të përmirësojë nivelin e bisedimeve me Serbinë e as nuk do të arrijë të garantojë transparencë dhe gjithpërfshirje. Pra, shumica e qytetarëve përkatësisht 60% nuk presin që përfshirja e Presidentit Thaçi të jetë garancë për një proces më transparent dhe gjithpërfshirës.

### **03** Kuvendi të ketë rol më të fuqishëm në procesin e dialogut

Afërsisht gjysma e qytetarëve përkatësisht 48% e tyre vlerësojnë që Kuvendi i Kosovës duhet të kërkojë raportim të rregullt dhe transparencë nga Ekipi Negociator, nga Presidenti dhe Qeveria, para dhe pas çdo raundi të bisedimeve të zhvilluara në Bruksel.

### **04** BE të bëhet garantuese e marrëveshjeve

Rreth 76% e qytetarëve ndajnë mendimin që BE duhet të bëhet garantuese e marrëveshjeve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke vendosur sanksione/kushtëzuar palët që nuk i zbatojnë marrëveshjet e Brukselit.

# REKOMANDIME

**01** Kuvendi i Kosovës duhet t'i japë legjimitet fazës së re të dialogut me anë të miratimit të një Rezolute e cila përcakton përbërjen e ekipit negociues, çështjet të cilat duhet të diskutohen dhe përfshirjen e këtij institucioni në këtë proces.

**02** Faza e re e dialogut Kosovë-Serbi të garantojë gjithpërfshirje të spektrit politik vendor dhe shoqërisë civile.

**03** Të ndërtohet një platform e qartë dhe e mirëdefnuar e diskutimeve mbi bazën e një diskutimi të gjerë institucional dhe qytetar për të garantuar gjithpërfshirje dhe transparencë duke artikuluar qartë epilogun e pritshëm të këtij procesi.

**04** Marrëveshjet e arritura duhet të kenë mekanizma zbatues, afate kohore të përcaktuara qartë si dhe një rol të shtuar të BE-së në garantimin e zbatimit të marrëveshjeve dhe ndëshkimit të palëve në rrugëtimin e tyre drejtë BE-së për moszbatimin e marrëveshjeve tashmë të arritura.



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Federal Department of Foreign Affairs FDFA**